

TË GJITHË e pandehnin të vdekur. Në vitin 1988, kur u botua libri im për filmat e tij, për Hektor Manin nuk ishte marrë më vesh asgjë prej pothuaj gjashtëdhjetë vjetësh. Përveç një grushti historianësh dhe adhuruesish të vjetër filmash, pak njerëz dukej se e dinin që ai kishte ekzistuar. *Dyfish ose asgjë*, pjesa e fundit e dymbëdhjetë komedive dy bobinëshe të cilat i realizoi nga fundi i epokës së filmave pa zë, u shfaq nëpër salla më 23 nëntor të 1928-ës. Pas dy muajsh, pa u ndarë nga asnjë shok apo bashkëpunëtor, pa lënë ndonjë letër apo njoftuar kënd për planet e tij, doli nga shtëpia me qira në North Orinxi Draiv dhe askush nuk e pa më. DeSotoja blu ishte parkuar në garazh, kontrata e shtëpisë ishte e vlefshme edhe për tre muaj, qiraja ishte paguar rregullisht. Në kuzhinë kishte ushqime, në dollapin e pijeve uiski dhe nëpër sirtarët e dhomës së gjumit nuk mungonte asnjë prej veshjeve të Hektorit. Sipas “Los Anxheles Herald Ekspresit” të 18 janarit 1929, *dukej sikur kishte dalë për një shëtitje të shkurtër dhe se do të kthehej nga çasti në çast*. Por nuk u kthye, dhe që nga ajo ditë, dukej sikur Hektor Mani ishte zhdukur nga faqja e dheut.

Pas zhdukjes së tij, për disa vite qarkulluan fjalë mbi atë çka mund t’i kishte ndodhur, por asnjë prej hipotezave nuk arriti të zbulonte gjë. Nga më të logjikshmet, një vetëvrasje apo vrasje, nuk qe e mundur as të vërtetoheshin as të përgënjeshtroheshin, duke qenë se trupi nuk u gjend dot kurrë. Të tjera hamendje rreth fatit të Hektorit qenë më fantastike, më optimiste, më të përputhshme me koklavitetet romantike të një çështjeje si e tija. Sipas njëres prej tyre, ai qe kthyer në Argjentinë, vendlindjen e tij, ku kishte blerë një cirk të vogël province. Sipas një tjetre, ishte bërë anëtar i partisë komuniste dhe po kryente veprimtari organizative me emër të rremë midis punëtorëve të bulmetit në Utikë, në Nju Jork. Në një të tretë, i hipte e i zbriste trenave si një endacak tipik i depresionit. Po të kishte qenë një yll i vërtetë kinemaje, trillimet pa dyshim që do të kishin vazhduar; do të kishte mbijetuar në legjendë, duke u shndërruar dora-dorës në një nga ato figura emblematike të cilat jetojnë në katet e ulëta të kujtesës kolektive, një simbol i rinisë, i shpresës dhe i kthesave djallëzore të fatit. Por në fakt nuk ndodhi asgjë e tillë, sepse në të vërtetë nga fundi i karrierës, Hektori sapo kishte nisur të bënte emër në Hollivud. Kishte mbërritur shumë vonë për të shfrytëzuar plotësisht talentin, dhe nuk kishte ndenjur mjaftueshëm për të lënë një përshtypje të qëndrueshme të vetes apo të asaj që mund të bënte. Kaluan edhe disa vite, e pak nga pak njerëzit reshtën së menduari për të. Që prej 1932-shit apo 1933-shit, Hektori i përkiste një universi të zhdukur, dhe nëse kishte mbetur ndonjë gjurmë prej tij, nuk ishin veçse shënime në fund të faqes së një libri të humbur që askush nuk e lexonte më. Tanimë filmat kishin zë, dhe shfaqjet e dredhura memece të së shkuarës u harruan. Nuk kish më klounë, as pantomimistë, e as vajza bukuroshe me maska që vallëzonin sipas muzikës së një orkestre të padëgjuar. Ata filma kishin vdekur vetëm para disa vitesh, por dukeshin ndërkaq parahistorikë, si krijesa që endeshin mbi tokë kur njeriu jetonte ende në shpella.

Në librin tim nuk jepja shumë informacion për jetën e Hektorit. *Bota pa zë e Hektor Mani* nuk ishte biografi, por një studim i filmave të tij, dhe të gjitha faktet anekdotike rreth veprimtarive jashtë ekranit që përfshiva ishin marrë nga burimet më të autorizuara: enciklopedi të kinemasë, kujtime, histori të kohës heroike të Hollivudit. E shkrova librin sepse doja të ndaja me të tjerë pasionin për punën e Hektorit. Historia e jetës së tij më interesonte pak, dhe në vend që të spekuloja për atë që mund apo nuk mund t’i kishte ndodhur, u kufizova me një analizë të thellë të veprave të tij. Meqenëse kishte lindur në 1900-ën dhe nuk e kishin parë më që prej 1929-ës, nuk do të më kishte shkuar kurrë nëpër mend të sugjeroja që Hektor Mani ishte ende gjallë. Të vdekurit nuk dalin nga varret, dhe për aq sa më takonte, vetëm një i vdekur mund të qëndronte i fshehur aq gjatë.

Marsin e shkuar kishin kaluar njëmbëdhjetë vjet nga dalja në treg e librit, i botuar nga University of Pennsylvania Press. Pas tre muajsh, pikërisht ndërsa fillonin të shfaqeshin recensionet e para nëpër periodikët e kinemasë dhe revistat akademike, gjeta një zarf në kutinë e postës. Ishte më i madh dhe më i gjerë nga formati standard që shitet nëpër dyqane, dhe prej letre të trashë e luksoze, kështu që në fillim mendova se bëhej fjalë për ndonjë ftesë dasme ose njoftim për lindje fëmije. Emri dhe adresa ime ishin shkruar përgjatë zarfit me një kaligrafi elegante e dredha-dredha. Në qoftë se nuk ishte shkrimi i një kaligrafi profesionist, duhej pa dyshim t’i përkiste një personi të bindur për fisnikërinë e bukurshkrimin të hijshëm, një personi të

shkolluar në akademitë e vjetra të mirësjelljes dhe etiketës. Mbi pullë ishte vula e Albakërkit, Nju Meksiko, por adresa e dërguesit nga ana e pasme tregonte që letra ishte shkruar gjetkë, duke marrë për të mirëqenë që një vend i tillë ekzistonte dhe se emri i qytetit ishte i vërtetë. Në dy rreshta njëri mbi tjetrin ishte shkruar: Blu Stoun Ranç; Tierra del Suenjo, Nju Meksiko. Ndoshta buzëqesha duke parë ato fjalë, por tani nuk e mbaj më mend. Nuk kishte emër, dhe ndërsa hapa zarfin për të lexuar mesazhin në letrën brenda tij, ndjeva një aromë të lehtë parfumi, një gjurmë pothuaj të pakapshme esence livandoje.

Pusulla thoshte: *I dashur profesor Zimer, Hektori e ka lexuar librin tuaj dhe do të dëshironte t'ju njihte. Do t'ju interesonte të vinit të na takonit? Me nderime, Frida Spelling Man.*

E rilexova gjashtë a shtatë herë. Pastaj e lashë, shkova deri në fund të dhomës dhe u ktheva mbrapsht. Kur e mora përsëri në dorë, nuk isha i sigurt që ato fjalë do të ishin ende aty. Ose në qoftë se ishin, që do të ishin të njëjtat. E lexova edhe gjashtë a shtatë herë të tjera; pastaj, ende i pasigurt për asgjë, vendosa që ishte një shaka. Një çast më vonë isha plot dyshime, dhe pas një tjetër çasti fillova të dyshoja për dyshimet e mia. Të mendoja një gjë donte të thoshte të mendoja të kundërtën e saj, dhe ai mendim nuk arrinte të fshinte mendimin fillestar se një i tretë lindte për të fshirë të dytin. Duke mos ditur ç'të bëja tjetër, hipa në makinë dhe shkova në postë. Në Amerikë, në regjistrin e kodeve postare janë renditur të gjitha adresat dhe po të mos gjeja Tierra del Suenjon mund ta flakja tej pusullën dhe ta harroja fare atë ndodhi. Por ishte. E gjeta në faqen 1933 të volumit të parë, në rreshtin ndërmjet Tierra Amarijës dhe Tiherës; ishte një qytezë e vërtetë me postë dhe kod pesëshifror. Natyrisht që kjo nuk garantonte vërtetësinë e letrës, por sidoqoftë i jepte një pamje besueshmërie, dhe kur u ktheva në shtëpi kisha vendosur se duhej t'i përgjigjesha. Një letër e atillë nuk mund të shpërfillet. Pasi e ke lexuar, është e pashmangshme ose të ulesh e të shkruash një përgjigje, ose të vazhdosh të mendosh për të gjithë jetën.

Nuk kam ruajtur një kopje të përgjigjes, por mbaj mend që e shkrova me dorë, duke u përpjekur të isha sa më lakonik, të kufizohesha në pak fjali. Pa e menduar gjatë, u gjenda duke përdorur të njëjtin stil të zhveshur e të prerë të letrës që kisha marrë. Në këtë mënyrë ndihesha më pak i cenueshëm, më pak i zbuluar për t'u bërë idiot në sytë e personit që kishte trilluar shakanë... nëse bëhej vërtet fjalë për një shaka. Përgjigja ime ishte pak a shumë kështu: *E dashur Frida Spelling, sigurisht që do të më pëlqente të takoja Hektor Manin. Po si mund të jem i sigurt që është gjallë? Me sa di unë, askush nuk e ka parë më që prej gjysmë shekulli. Ju lutem të më jepni më tepër hollësi. Me respekt, Deivoid Zimer.*

**T**Hem se të gjithë dëshirojmë të besojmë tek e pamundshmja për t'u bindur se mrekullitë mund të ndodhin vërtet. Meqenëse isha autori i librit të vetëm që ishte shkruar ndonjëherë për Hektor Manin, do të ishte logjike të mendoje se e rrëmbeva në çast mundësinë për ta besuar ende gjallë. Por nuk isha në humor për t'u rrëmbyer. Ose të paktën nuk mendoja se isha. Libri im kishte lindur nga një dhembje e madhe, dhe tani që e kisha lënë pas librin, dhembja ishte ende e pranishme. Të shkruaja për komedi nuk kishte qenë asgjë më tepër se një pretekst, një lloj bari i çuditshëm që kisha gëlltitur çdo ditë për më tepër se një vit, me shpresën e largët se do të zbutte dhembjen që kisha brenda vetes. E deri në njëfarë pike, kështu kishte qenë. Por Frida Spellingu (ose cilado që hiqej si Frida Spellingu) nuk mund ta dinte. Nuk mund të dinte se më 7 qershor 1985, pikërisht një javë përpara përvjetorit të dhjetë të martesës, ime shoqe dhe dy djemtë kishin vdekur në një aksident ajror. Ta zëmë se e kishte vënë re që libri u ishte kushtuar atyre (*Në kujtim të Helenës, Todit dhe Markos*); gjithsesi ata emra nuk mund të kishin ndonjë domethënie për të, e edhe pse mund ta kishte marrë me mend rëndësinë për autorin, nuk mund ta dinte që për të përfaqësonin gjithçka ka kuptim në jetë, dhe se në çastin kur Helena, tridhjetë e gjashtë vjeçe, Todi, shtatë vjeç, dhe Markoja, katër vjeç, kishin vdekur, pjesa më e madhe e tij kishte vdekur bashkë me ta.

Ishin nisur për në Miluoki për të vizituar prindërit e Helenës. Unë kisha qëndruar në Vermont për të korrigjuar provimet dhe për të dorëzuar notat përfundimtare të semestrit që sapo kish mbaruar. Ishte puna ime, profesor letërsie të krahasuar në Kolegjin e Hamptonit, Vermont, dhe duhej ta bëja. Normalisht, do të kishim marrë avionin të gjithë së bashku më njëzet e katër ose njëzet e pesë, por babai i Helenës sapo ishte operuar për një tumor në këmbë, dhe familja vendosi njëzëri që ajo dhe djemtë të niseshin sa më parë. Kjo përfshiu disa bisedime të ndërlikuara të çastit të fundit me shkollën e Todit për të marrë leje që të shkëputej dy javët e fundit nga klasa e dytë. Drejtoresha u tregua ngurruese por e kuptueshme, dhe në fund pranoi. Qe një prej hollësive për të cilat vazhdova të mendohesha pas aksidentit. Vetëm po të kishte refuzuar, Todi do të ishte detyruar të qëndronte në shtëpi me mua, dhe nuk do të kishte vdekur. Të paktën njërit prej tyre do kishte shpëtuar. Të paktën njëri prej tyre nuk do të kishte rënë për dhjetë mijë metra në qiell, dhe unë nuk do të kisha mbetur vetëm në një shtëpi të bërë për katër vetë. Kishte aspekte të tjera, natyrisht, përkime të tjera për të bluar me mendje e për të torturuar veten; dhe më dukej se nuk lodhesha kurrë së përshtuar

sërisht të njëjtat rrugë pa krye. Gjithçka i përkiste këtij tmerri: çdo hallkë në zinxhirin shkak-efekt që një pjesë thelbësore e tij; nga tumori në këmbë i vjehrrit te moti i asaj jave në Miduest, te numri i telefonit i agjencisë që na kishte prenotuar biletat e avionit. Por gjëja më e keqe ishte këmbëngulja ime për t'i shoqëruar deri në Boston në mënyrë që të merrnin fluturimin e drejtpërdrejtë. Nuk doja të niseshin nga Bërlingtoni, sepse do t'iu duhej të fluturonin me një avion tetëmbëdhjetë vendësh deri në Nju Jork dhe atje të merrnin avionin për Miluoki, dhe i thashë Helenës që ata avionë të vegjël nuk më pëlqenin. Ishin shumë të rrezikshëm, thashë, dhe nuk mund ta duroja idenë që të lija që ajo dhe djemtë të ngjiteshin pa mua. Për këtë arsye, për të mos më shqetësuar, u nisën me një avion më të madh, dhe gjëja më e tmerrshme ishte se i dhashë makinës si i çmendur për të mos e humbur. Kishte shumë trafik atë mëngjes, dhe kur më në fund mbërritëm në Springfield dhe morëm Masaçusets Tërnpaikun, m'u desh ta kaloja kufirin e shpejtësisë për të mbërritur në Logan në kohë.

Nga ajo që më ndodhi atë verë mbaj mend shumë pak. Për disa muaj jetova në një mjegull etilike dhembjeje dhe vetëmëshirimi; nuk dilja pothuaj asnjëherë, nuk mendoja pothuaj asnjëherë për të ngrënë, për t'u rruar, apo për t'u ndërruar. Pjesa më e madhe e kolegëve nuk ishte në punë deri nga mesi i gushtit, kështu që nuk isha i detyruar të duroja shumë vizita, të qëndroja ulur për të kaluar protokollat dërrmuese të zisë së përbashkët. Të tjerët, natyrisht, ishin dashamirës, dhe sa herë që vinte ndonjë nga miqtë e mi, e ftoja gjithnjë brenda, por përqaftimet e tyre të përplotura e heshtjet e gjata të sikletshme nuk më ndihmonin. Zbulova se ndiheshja më mirë vetëm, që qe më mirë t'i shtyja ditët në terrin e mendjes sime. Kur nuk isha i dehur apo i shtrirë sa gjatë gjerë në divanin e sallonit duke parë televizor, e kaloja kohën duke u vërdallosur nëpër shtëpi. Hyja në dhomat e djemve dhe ulesha në dysheme, i rrethuar nga gjërat e tyre. Nuk isha në gjendje të mendoja për ta në mënyrë të drejtpërdrejtë, e as t'i thërrisja me vetëdije, por kur bashkoja pjesët e mozaikëve apo luaja me kubat e Legos, duke ndërtuar struktura gjithnjë e më tepër të ndërlikuara e baroke, ndieja që jetoja ende përkohësisht me ta, që i jepja vazhdimësi dy jetëve të vogla fantazmë duke përsëritur gjestet e kryera prej tyre kur zotëronin një trup. Lexoja librat e përrallave të Todit dhe organizoja kartat e tij të bejsbollit. Klasifikoja kafshët e pelushit të Markos sipas specieve, ngjyrës dhe masës, duke e ndryshuar sistemin sa herë që hyja në dhomë. Në këtë mënyrë orët avullonin, ditë të tëra shkriheshin në harresë, dhe kur nuk arrija ta duroja më, kthehesha në sallon dhe mbushja një tjetër gotë. Ato net të rralla kur nuk më binte të fikët në divan, zakonisht flija në shtratin e Todit. Në timin, shihja gjithnjë ëndërr Helenën pranë meje, dhe çdo herë që përpiqesha ta përqafoja, zgjohesha befas, dhunshëm, me duart që më dridheshin e mushkëritë që gulçonin në kërkim të ajrit, si të kisha qenë duke u mbytur. Kur binte nata, nuk mund të hyja në dhomën tonë, por kaloja shumë kohë gjatë ditës aty, brenda dollapit në mur të Helenës, duke prekur veshjet e saj, duke rregulluar xhaketat dhe pulovrat, duke hequr fustanet nga varëset e duke i shpërndarë në dysheme. Një herë veshja një, një herë tjetër veshja të brendshmet dhe leva fytyrën me makiazhin e saj. Ishte përvojë shumë e kënaqshme, por pas eksperimentesh të tjera, zbulova se parfumi ishte edhe më i efektshëm se i kuqi i buzëve dhe rimeli. Dukej se ma kthente në mënyrë më të gjallë, e ndillte për një kohë më të gjatë praninë e saj. Për fat të mirë, le ta quajmë kështu, në mars, me rastin e ditëlindjes, i kisha dhuruar një shishe Shanel nr. 5 për ta patur rezervë. Duke e hedhur në doza të vogla dy herë në ditë, arrita ta bëja të zgjaste deri në fund të verës.

Për semestrin e vjeshtës mora lejen, por në vend që të largohesha ose të kërkoja ndihmë psikologjike, qëndrova në shtëpi dhe vazhdova të fundosesha. Nga fundi i shtatorit, apo fillimi i tetorit, rrëkëlleja më shumë se gjysmë shisheje uiski çdo natë. Kjo më lejonte të mos ndieja shumë, por në të njëjtën kohë më hiqte çdo ndjenjë të së ardhmes, dhe kur një njeri nuk ka asgjë për të dëshiruar, është si të jetë i vdekur. Shpeshherë e shkundja veten nga fantazi të gjata mbi hape gjumi e gaz monoksidi karboni. Nuk arrita kurrë deri në veprim, por tani, nëse i risjell nëpër mend ato ditë, kuptoj sesa afër kam qenë. Hapet ishin në dollap, dhe e kisha marrë ndërkaq tre apo katër herë shishkën nga rafti; kisha arritur t'i hidhja në pëllëmbë. Nëse ajo gjendje do të kishte vazhduar, s'besoj se do ta kisha patur forcën t'i bëja ballë.

Kjo ishte gjendja kur Hektor Mani hyri papritur në jetën time. Nuk e kisha idenë se cili ishte, nuk ia kisha dëgjuar as rastësisht emrin, por një mbrëmje, pikërisht përpara fillimit të dimrit, kur pemët ishin zhveshur ndërkaq nga gjethet dhe kërcënonte dëbora e parë, rastisi të shihja në televizor një skenë nga një prej filmave të tij të vjetër që më bëri të qesh. Mund të duket e parëndësishme, por që nga qershori ishte hera e parë që qeshja, për çfarëdolloj arsyeje, dhe kur ndjeva gulçin e beftë të më ngjitej nga gjoksi e të niste të ushtonte në mushkëri, kuptova se nuk kisha prekur ende fundin, se një pjesë e imja kishte ende dëshirë të vazhdonte të jetonte. E qeshura nuk mund të ketë zgjatuar më tepër se disa sekonda. Nuk qe veçanërisht e zhurmshme e as e gjatë, por më zuri në befas; e meqenëse nuk e përmbajta dhe nuk ndjeva turp që e kisha harruar trishtimin në ato pak çaste kur Hektor Mani ishte shfaqur në ekran, isha i detyruar të pranoja që brenda meje kishte diçka që nuk e kisha përfytyruar më parë, diçka ndryshe nga vdekja e thjeshtë dhe e

pastër. Nuk e kam fjalën për ndonjëfarë intuïte të turbullt apo për dëshirë sentimentale për atë që do të mund të kishte qenë. Kisha bërë një zbulim empirik, që përmbante të gjithë peshën e një prove matematike. Në qoftë se kisha në vetvete aftësinë për të qeshur, donte të thoshte se nuk isha krejtësisht i plogët. Donte të thoshte se nuk isha veçuar nga bota aq plotësisht sa të mos lejoja më të më prekte asgjë.